

Mirëmëngjesi fëmijë të dashur, përfaqësues të institucioneve dhe të nderuara media,

Jam i nderuar që jam në mesin tuaj sot, dhe ju përgëzoj për bashkëpunimin tuaj për organizmin dhe shënimin e **Javës Ndërkombëtare të Parasë**.

Banka Qendrore është institucion i pavarur i Republikës së Kosovës, që i mbikëqyrë bankat e tjera komerciale.

Nga lënda e edukatës qytetare ju nxënës mësoni, se cilat janë institucionet e Republikës së Kosovës, gjithashtu mësoni edhe për bankat ku qytetarët i ruajnë paratë (kursimet) e tyre, marrin kredi ,kryejnë pagesa etj.

Ne sot jemi mbledhur për të shënuar fillimin e Javës Ndërkombëtare të Parasë. Këtë vit motoja e kësaj jave është **“Mëso, Kurse dhe Fito”**. Kjo javë shënohet në tërë botën përmes organizimit të aktiviteteve dhe ngjarjeve të ndryshme. Edhe në Kosovë tashmë është bërë traditë, shënimi i kësaj jave.

Objektivë parësore e Bankës Qendrore të Kosovës, është ruajtja e stabilitetit financiar në Kosovë. Për të kontribuar në këtë drejtim, BQK-ja ndërmerr shumë veprime ligjore për t’ju siguruar qytetarëve të Kosovës, institucione të mirëfillta financiare, stabile në mënyrë që parat e qytetarëve të jenë të sigurta.

Në të njëjtën kohë edhe qytetarët duhet të jenë të informuar dhe të përgatitur që të marrin vendime të drejta dhe të shëndosha financiare.

Sikur për të gjitha gjërat tjera që i kemi në jetën e përditshme, edhe parat janë ato që secili nga ne i përdorim për plotësimin e kërkesave, dëshirave dhe nevojave tona. Për t’i menaxhuar në mënyrë të duhur, ne duhet të **mësojmë** për paratë, financat e çdo gjë që ka të bëjë me to.

Megjithatë për të kursyer paratë ne së pari duhet t’i kemi ato, apo jo? Nga vijnë paratë?

Parat fitohen nga puna e cila shpërblehet me para, d.m.th. shpërblimi për punën që prindërit tuaj e bëjnë çdo ditë.

Si të mësoni që të kurseni?

Paratë duhet t'i shpenzoni vetëm për gjërat e nevojshme d.m.th. ushqim, veshmbathje, libra fletore (edhe ndonjëherë për ndonjë lodër).

Ne si prindër, gjithmonë kemi dëshirë që t'ua plotësojmë të gjitha dëshirat dhe t'u shpërblejmë me dhurata apo para sa herë, që ju tregoni rezultate në shkollë, ndihmoni në shtëpi dhe na bëni krenar me të arriturat tuaja. Por dhe më shumë krenar do t'na bëni nëse paratë të cilat ua japim do t'i kurseni dhe do t'i shpenzoni me kujdes.

Natyrisht që po flasim për shumë të vogël të parave që prindërit apo të afërmit iu dhurojnë, si rezultat i sjelljes së mirë, rezultateve në shkollë apo me rastin e festave. Por mos harroni fuqia e një centi apo një euroje është shumë e madhe dhe fuqinë tyre ju mund ta kuptoni vetëm atëherë kur shkoni në dyqan, dëshironi të blini diçka dhe ju mungon një cent apo një euro për ta blerë atë.

Prandaj gjithmonë mbajeni mend se paraja rritet pak nga pak dhe një ditë do të jeni të befasuar sa shumë para do t'i keni nëse ato i keni kursyer nga pak çdo ditë apo çdo javë. Kur paranë e keni në dorën tuaj, ajo është e juaja, por kur e harxhoni nuk mund ta ktheni parapa, prandaj kursejeni atë me shumë kujdes në mënyrë që kur të vijë koha ju të mund ta shpenzoni për gjërat që kanë rëndësi dhe vlerë siç janë p.sh. librat, fletoret, biçikleta, studimet dhe natyrisht edhe ndonjë lodër apo çokollatë aty këtu.

Unë shpresoj shumë që edhe aktivitetet e organizuara gjatë kësaj jave do t'ju mësojnë juve që të kuptoni rëndësinë e vlerës dhe kursimit të parasë dhe gjithashtu shpresoj që këtë mësim të sotëm do ta ndani edhe me shokët dhe shoqet e tjera në klasën dhe shkollën tuaj.

Faleminderit të gjithëve për praninë tuaj sot dhe suksese.